



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Q endrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.2

3 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7226 datë 12.1.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	35
Dekret nr.7227 datë 16.1.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	35
Vendim i KM nr.16, datë 4.1.2012	Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor.....	36
Vendim i KM nr.17, datë 4.1.2012	Për një ndryshim në vendimin nr.662, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në bashkinë Konispol” dhe “Për një ndryshim në vendimin nr.894, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të bashkisë Konispol, të qarkut të Vlorës””	41
Vendim i KM nr.19, datë 11.1.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të ceremonive funebre shtetërore dhe zyrtare, në nderim të të ndjerit Leka Zogu I e të të ndjerit Sabri Godo, dhe për disa ndryshime në vendimet nr.808, datë 30.11.2011 dhe nr.825, datë 3.12.2011 të Këshillit të Ministrave.....	44
Vendim i KM nr.20, datë 11.1.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr.839, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për rimbursimin e akcizës së paguar dhe krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW”.....	44

Vendim i KM nr.21, datë 11.1.2012	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 9 bashki dhe 19 komuna.....	46
Vendim i KM nr.22, datë 11.1.2012	Për dhënie fondi shtesë komunës Markat, të nënprefekturës Sarandë, për zbatimin e projektit emergjent “Ndërtim muri mbajtës dhe sistemim i ujërave të shiut në Qendër Shalës”.....	47
Vendim i KM nr.23, datë 11.1.2012	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2011-2012.	47
Vendim i KM nr.51, datë 2.2.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe totale 45 000 m ² , pjesë e pronës nr.117, me emërtim “Kompania e zbulimit, raketave KT, të BRRSH”, me vendndodhje në Sharrë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	51
Udhëzim i MB nr.7, datë 10.1.2012	Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve, që do të plotësohen nga përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe të bashkive/njërive bashkiake/komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile”.....	53
Urdhër i MASH nr.6, datë 5.1.2012	Për lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe të programeve të studimit jouniversitare profesionale, institucionit të arsimit të lartë privat “Akademia e Ndërtimit e Tiranës” në përputhje me licencën e dhënë.....	57
Urdhër i MASH nr.10, datë 17.1.2012	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë që përfundojnë me “Master profesional” dhe “Master i shkencave”, shkollës së lartë private “Hëna e plotë” (Bedër) Tiranë.....	57
Urdhër i MASH nr.11, datë 17.1.2012	Për hapjen e programeve të reja të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji”, “Teknologji informacioni dhe komunikimi” dhe “Inxhinieri telekomunikacioni” dhe programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Arkitekturë” dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe, pranë shkollës së lartë private “Vitrina”, Tiranë.....	58
Urdhër i MASH nr.12, datë 17.1.2012	Për hapjen e programeve të reja të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Psikologji shkollore dhe e zhvillimit” dhe “Psikologji këshillimi klinik” dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe, pranë shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë.....	59

Urdhër i MASH nr.16, datë 17.1.2012	Për riorganizimin e Fakultetit të Mësuesisë në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë dhe në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në universitetin “Fan.S.Noli” Korçë.....	60
Vendim i GJK nr.1, datë 20.1.2012	Me objekt shfuqizimin, si antikushtetues, të vendimeve nr.10-2008-166 (301), datë 3.6.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.00-2010-481, datë 23.4.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; - Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.....	62
Vendim i GJK nr.2, datë 25.1.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve nr.15, datë 20.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.346, datë 15.12.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr.00-2009-315, datë 6.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	67

DEKRET
Nr.7226, datë 12.1.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Rona Sheref Nishliu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.7227, datë 16.1.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, 10 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|----------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Ali Nimetullah Ikikardeş | 18. Fahir Fevzi Tatar |
| 2. Ridvan Hakki Ikikardeş | 19. Kubilay Taner Giray |
| 3. Sabri Hasan Ikikardeş | 20. Elena Sergiu Malaj (Ploşnită) |
| 4. Ilayda Sabri Ikikardeş | 21. Sadullah Muzaffer Yılmaz |
| 5. Hasan Sabri Ikikardeş | 22. Giorgio Vito Antonio Gallesio |
| 6. Diğdem Zeki Asllani (Kiziler) | 23. Orhan Shabi Osmani |
| 7. Mustafa Orhan Erdem | 24. Merita Salih Bilali (Zekaj) |
| 8. Ilyas Ramazan Karagöz | 25. Metin Fevzullah Abakay |
| 9. Mehmet Süleyman Anakaya | 26. Adnan Mehmet Yildizoğlu |
| 10. Çiğdem Şerif Anakaya | 27. Aydın Mehmet Bağatır |
| 11. Hazal Mehmet Anakaya | 28. Azize Mehmet Şerif Bağatır |
| 12. Hakan Mustafa Yozgatli | 29. Mehmet Akif Aydın Bağatır |



- | | |
|--------------------------------|-------------------------------|
| 13. Hacer Mahmut Yozgatli | 30. Melek Aydin Bağatir |
| 14. Tuana Elif Hakan Yozgatli | 31. Eljmaz Berzat Idrizi |
| 15. Fatih Berk Hakan Yozgatli | 32. Nazmije Azir Idrizi |
| 16. Vincenzo Mario Pelliccione | 33. Burhan Kadir Kasimoğlu |
| 17. Hasan Ismail Gün | 34. Sihana Vebi Azemi (Veliu) |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.16, datë 4.1.2012

PËR TË DREJTËN E PUBLIKUT PËR TË PASUR INFORMACION MJEDISOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt:

- a) t'i sigurojë publikut shpërndarjen në mënyrë të vazhdueshme e sistematike të informacionit mjedisor dhe vënien e këtij informacioni në dispozicion të tij;
- b) të përcaktojë kushtet dhe mënyrat e duhura për ushtrimin e së drejtës për të pasur informacion mjedisor, për shkëmbimin e opinionit të publikut, si dhe për pjesëmarrjen efektive të tij në vendimmarrjen mjedisore.

2. Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Informacion mjedisor” ka kuptimin e referuar në ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 “Për aderimin e Shqipërisë në Konventën e Aarhusit”, sipas këtyre kategorive:

Kategoria e parë: çdo material informues, që u referohet elementeve mjedisore të vendit, ku përfshihen të dhënat për ajrin e brendshëm dhe të jashtëm, atmosferën, ujin, tokën, peizazhin, zonat natyrore, burimet natyrore, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tyre, organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe bashkëveprimi i të gjitha këtyre elementeve.

Kategoria e dytë: faktorët natyrorë, substancat, energjia, zhurmat, radoni apo niveli i rrezatimit, si dhe aktivitetet ose masat e marra, përfshirë masat administrative, marrëveshjet në fushën e mjedisit, politikat, legjislacioni, planet dhe programet, që ndikojnë ose pritet të ndikojnë në elementet e mjedisit, të përfshira në kategorinë e parë, dhe përfitimet e analizat ekonomike si pasojë e vendimmarrjes mjedisore.

Kategoria e tretë: të dhëna për sigurinë e shëndetit dhe kushteve të jetës së njerëzve, gjendjen aktuale të zonave kulturore dhe ndikimet e mundshme të faktorëve të kategorisë së dytë mbi këto zona.

b) “Autoritet publik” ka kuptimin e referuar në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

c) “Informacion i mbajtur nga autoriteti publik”, informacioni i prodhuar ose i marrë nga autoriteti publik.

ç) “Informacion që mbahet për autoritetin publik”, informacioni mjedisor, që mbahet fizikisht nga personat, fizikë apo juridikë, për llogari të autoritetit publik.

d) “Aplikues”, çdo person, fizik dhe juridik, që kërkon informacion mjedisor.

dh) “Publik” ka kuptimin që jepet në pikën 12 të nenit 5 të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

KREU II

SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT MJEDISOR DHE VËNIA NË SHËRBIM TË PUBLIKUT

1. Shpërndarja e informacionit mjedisor realizohet, si më poshtë vijon:

a) Autoriteti publik grumbullon dhe organizon informacionin mjedisor, që lidhet me funksionet e tij, për t’ia shpërndarë publikut sistematikisht me anë të të gjitha formave që disponon, përfshirë atë me shkrim, vizuale, gojore dhe me mjetet elektronike të komunikimit.

b) Autoriteti publik e ruan informacionin mjedisor, që lidhet me funksionet e tij, në forma lehtësisht të riprodhueshme dhe të mundshme për t’iu vënë në shërbim të publikut në mënyrën që i kërkohet, përfshirë dhe mjetet e komunikimit elektronik.

c) Kur aplikuesi kërkon informacion mjedisor të grumbulluar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe kur ky informacion nuk ekziston në formë elektronike, atëherë ai nuk i vihet në shërbim aplikuesit me mjetet e komunikimit elektronik, por me formën që gjendet.

ç) Autoriteti publik informon publikun në mënyrën e duhur për të drejtat që ai gëzon në kuadër të këtij vendimi dhe ofron informacion, udhëzime dhe këshilla për këtë qëllim.

2. Vënia dhe shpërndarja e informacionit të disponueshëm në shërbim të publikut realizohen, si më poshtë vijon:

a) Autoriteti publik përkatës vë në shërbim të publikut dhe ia shpërndan atij informacionin e mëposhtëm të cilin disponon:

i) Tekstet e konventave ose marrëveshjeve ndërkombëtare, tekstet e Komunitetit European, aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare ose vendore që lidhen me mjedisin;

ii) Politikat, strategjitë, planet dhe programet që lidhen me mjedisin;

iii) Raportet për progresin e bërë në lidhje me zbatimin e nënndarjeve “i” dhe “ii”, të kësaj pike, në rastet kur ato përgatiten dhe/ose disponohen nga autoriteti publik;

iv) Raportet për gjendjen e mjedisit;

v) Të dhënat ose përmbledhjen e të dhënave të mbledhura nga monitorimi i veprimtarive që ndikojnë ose që mund të ndikojnë në mjedis;

vi) Autorizimet, lejet dhe licencat për veprimtaritë me ndikim në mjedis dhe marrëveshjet mjedisore ose të dhëna për vendin se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion;

vii) Studimet për ndikimin mjedisor dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me elementet mjedisore, siç janë ajri dhe atmosfera, uji, toka, vendet piktoreske dhe natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare, zonat e mbrojtura, diversiteti biologjik dhe përbërësit e tij, duke përfshirë këtu edhe organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe ndërveprimin midis këtyre elementeve, ose një referencë se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion.

b) Autoriteti publik është i detyruar të përditësojë informacionin mjedisor të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike.

3. Shpërndarja e informacionit mjedisor, në rastin e kërcënimeve të pashmangshme, realizohet, si më poshtë vijon:



Autoriteti publik, kur gjykon se ekziston një kërcënim i pashmangshëm për shëndetin e njerëzve apo mjedisin, i shkaktuar nga veprimtaria njerëzore apo si pasojë e shkaqeve natyrore, ia shpërndan menjëherë dhe pa vonesë publikut, që ndikohet apo mund të ndikohet nga ky kërcënim, të gjithë informacionin që disponon, me qëllim që publiku të marrë masa për të shmangur ose minimizuar dëmin e mundshëm dhe pasojat negative.

KREU III

PROCEDURAT PËR MARRJEN E INFORMACIONIT MJEDISOR NËPËRMJET KËRKESËS

1. Çdo aplikues ka të drejtë për të marrë informacion mjedisor nëpërmjet kërkesës dhe procedura e marrjes së këtij informacioni realizohet, si më poshtë vijon:

a) Autoriteti publik vë në dispozicion të çdo aplikuesi, sipas kërkesës së tij, informacionin mjedisor që ai mban.

b) Kur aplikuesi kërkon nga autoriteti publik informacion mjedisor, ai nuk është i detyruar të shprehë arsyet përse i nevojitet ky informacion.

c) Autoriteti publik e vë informacionin në dispozicion të aplikuesit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes së kërkesës në institucionin publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 6 të këtij kreu.

2. Shpërndarja e informacionit mjedisor realizohet sipas mënyrave ose formateve të mëposhtme:

a) Autoriteti publik, me përjashtim të rastit të shkronjave “b” dhe “c” të kësaj pike, vë në shërbim të aplikuesit informacionin mjedisor në atë mënyrë ose format që kërkohet prej tij, përfshirë këtu edhe kopje të materialeve të kërkuara.

b) Kur autoriteti publik nuk e zotëron informacionin mjedisor në mënyrën dhe formatin e kërkuar nga publiku, atëherë ia vë në shërbim në mënyrën dhe formatin që ai e zotëron duke dhënë dhe arsyet përse ky informacion është vënë në shërbim në atë mënyrë apo format.

c) Autoriteti publik, për qëllime të kësaj pike, ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për të ruajtur informacionin mjedisor në mënyrat ose formatet që janë lehtësisht të riprodhueshme dhe të arritshme me anë të mjeteve elektronike të komunikimit.

3. Përgjegjësitë e autoritetit publik janë, si më poshtë vijon:

a) Të mbështesë publikun gjatë kërkimit të së drejtës për të pasur në shërbim informacionin mjedisor.

b) T’ua vendosë në dispozicion dhe t’u mundësojë listën autoriteteve/institucioneve publike që kanë informacion mjedisor.

c) Të publikojë në vende të dukshme të gjithë strukturën që ka në dispozicion për shpërndarjen e informacionit mjedisor, përfshirë këtu caktimin e punonjësve të informacionit, krijimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për shqyrtimin e informacionit mjedisor të kërkuar, si dhe regjistrat ose listat e informacionit mjedisor, të zotëruara nga autoritetet publike, ose pikat informative, me përcaktime të qarta se ku mund të gjendet ky informacion.

4. Autoriteti publik, në rastin e vonesave në ofrimin e informacionit mjedisor si rezultat i volumit ose kompleksitetit të tij, vepron, si më poshtë vijon:

a) Kur ky autoritet vëren se volumi dhe kompleksiteti i informacionit është i tillë, që periudha prej 30 (tridhjetë) ditësh është e pamjaftueshme, afati i vënies në dispozicion të informacionit mjedisor të kërkuar dyfishohet duke e përllogaritur nga data e dorëzimit të kërkesës.

b) Ky autoritet informon me shkrim aplikuesin, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e marrjes së kërkesës, për zgjatjen e afatit kohor për kthimin e përgjigjes.

5. Autoriteti publik, në rastin e vonesave në dhënien e informacionit mjedisor si pasojë e paqartësisë së kërkesës, vepron, si më poshtë vijon:

a) Kur kërkesa për informacion mjedisor është formuluar në një mënyrë shumë të përgjithshme, ky autoritet i kërkon aplikuesit të specifikojë kërkesën jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e marrjes së saj.

b) Ky autoritet ndihmon aplikuesin në detajimin e kërkesës së tij, duke i ofruar informacion veçanërisht për përdorimin e regjistrave publikë, ashtu siç përcaktohet në shkronjën “c” të pikës 3 të këtij kreu.

6. Autoriteti publik, për përjashtimet nga publikimi i informacionit mjedisor, vepron, si më poshtë vijon:

a) Ky autoritet refuzon kërkesën për informacion mjedisor në rastet kur bërja publike e këtij informacioni ndikon negativisht në:

i) konfidencialitetin e procedurave të autoriteteve publike, kur kështu është përcaktuar në ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

ii) marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurinë publike ose mbrojtjen kombëtare;

iii) çështjet gjyqësore, në të drejtën e një personi për të pasur një proces të rregullt gjyqësor ose në të drejtën që mund të ketë një autoritet publik për të ndërmarrë një hetim me natyrë penale ose disiplinore;

iv) ruajtjen e sekretit tregtar ose industrial, në rastet kur parashikohet nga aktet ligjore në fuqi ose në rastet e parashikuara në legjislacionin përkatës dhe që lidhen me ruajtjen e interesit ekonomik legjitim, përfshirë këtu edhe interesin publik për të ruajtur sekretin statistikor dhe fshehtësinë e taksave;

v) të drejtat e pronësisë intelektuale;

vi) ruajtjen e të dhënave personale dhe/ose dosjeve që lidhen me një person fizik, kur ky person nuk ka dhënë miratimin e tij për ta bërë publik këtë informacion, sikurse parashikohet në ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ose nga akte të tjera ligjore në fuqi;

vii) interesat ose në mbrojtjen e çdo personi, i cili ka dhënë informacionin e kërkuar në baza vullnetare, pa qenë i detyruar ligjërisht për ta dhënë këtë informacion, në rastet kur personi nuk ka miratuar më parë publikimin e këtij informacioni;

viii) mbrojtjen e mjedisit, në rastet kur ky informacion lidhet me këtë fakt, sikurse është vendndodhja e llojeve të rralla dhe të rrezikuara.

b) Ky autoritet refuzon një kërkesë për të dhënë informacion mjedisor në rastet kur:

i) informacioni i kërkuar nuk mbahet nga/ose për autoritetin publik, të cilit i është bërë kërkesa. Në rastet kur autoriteti publik ka dijeni se ky informacion mbahet nga/ose për një autoritet tjetër publik, atëherë ai ia transferon kërkesën autoritetit përkatës, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe për këtë njofton me shkrim aplikuesin, brenda 10 (dhjetë) ditëve. Autoriteti publik informon dhe këshillon aplikuesin për t’ia drejtuar kërkesën e tij autoritetit përkatës të sugjeruar;

ii) kërkesa është qartësisht e paarsyeshme;

iii) kërkesa është e formuluar në mënyrë shumë të përgjithshme, sipas përcaktimit të dhënë në pikën 3 të këtij kreu;

iv) kërkesa lidhet me materiale që janë në procesin e plotësimit ose me të dhëna apo dokumente të papërfunduara. Autoriteti publik, në këtë rast, informon aplikuesin për emrin e autoritetit që përgatit materialin dhe kohën që nevojitet për plotësimin e tij;

v) kërkesa lidhet me komunikime të brendshme, duke pasur parasysh interesin publik si rezultat i nxjerrjes së informacionit.

c) Ky autoritet, përpara se të marrë vendim, rast pas rasti, për të refuzuar pjesërisht ose plotësisht kërkesën për informacion mjedisor, merr në konsideratë interesin publik, duke vlerësuar pasojën e nxjerrjes së informacionit, dhe e gjykon këtë interes kundrejt interesit si pasojë e refuzimit.



ç) Ky autoritet, pavarësisht nga përcaktimi i shkronjës “a” të kësaj pike, nuk refuzon kërkesën për informacion mjedisor, kur kjo kërkesë lidhet me dhënien e informacionit për shkarkimet në mjedis.

d) Ky autoritet, në rastet kur informacioni mjedisor i kërkuar nga aplikanti përfshihet në shkronjën “a” dhe nënndarjet “iv” dhe “v”, të shkronjës “b” të kësaj pike, ia vë në shërbim informacionin e kërkuar në mënyrë të pjesshme.

7. Autoriteti publik, për rastet e refuzimit për dhënien e informacionit mjedisor, jep arsyet, si më poshtë vijon:

a) Ky autoritet i jep aplikantit arsyet e refuzimit për të dhënë informacion të plotë apo të pjesshëm, me shkrim ose në mënyrë elektronike.

b) Ky autoritet jep arsyet e përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikat 1, shkronja “c”, e 3, të kreut III, të këtij vendimi.

c) Ky autoritet, kur jep arsyet për refuzimin, informon aplikuesin edhe për të drejtat që ai ka për ta apeluar në rrugë administrative apo gjyqësore vendimin e refuzimit, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Procedurave Administrative.

KREU IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Tarifat për dhënien dhe pajisjen me informacionin mjedisor janë, si më poshtë vijon:

a) Dhënia e informacionit mjedisor nga çdo regjistër publik ose listë e krijuar apo e mbajtur në përputhje me pikat 2 dhe 3, të kreut II të këtij vendimi, është pa pagesë.

b) Aplikuesi paguan tarifë për marrjen e informacionit, vetëm në rastet kur informacioni që kërkon është shumë voluminoz dhe nuk është informacion i disponueshëm, sipas pikave 2 dhe 3 të kreut II të këtij vendimi.

c) Tarifat për marrjen e informacionit mjedisor përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të Ministrit të Financave.

ç) Autoriteti publik publikon listën e këtyre tarifave, së bashku me informacionin për rrethanat, kur kjo tarifë paguhet ose jo.

2. Për rastet e shkeljeve të të drejtave ndiqet procedura e ankimit në rrugë administrative dhe gjyqësore, si më poshtë vijon:

a) çdo person, kur konstaton se janë shkelur të drejtat e tij, të njohura nga ky vendim, ankimon në rrugë administrative, siç përcaktohet në nenin 15 të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

b) çdo person, kur konstaton se janë shkelur të drejtat e tij, të njohura nga ky vendim, ankimon në rrugë gjyqësore, siç përcaktohet në nenin 16 të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe autoritetet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.17, datë 4.1.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.662, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, TË SHTETIT, NË BASHKINË KONISPOL” DHE “PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.894, DATË 11.6.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË KONISPOL, TË QARKUT TË
VLORËS””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të bashkisë Konispol. Lista është me 2 (dy) fletë dhe mbaron me numrin rendor 33.

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të kësaj njësie. Lista ka 2 (dy) fletë dhe mbaron me numrin rendor 33.

3. Ndryshimet në listën e inventarit dhe në listën përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi, si dhe lidhja nr.1 (një), i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Konispol e qarkut të Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Konispol

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
77,79	Kullotë	Pronësi
109-127	Kullotë	Pronësi
128-139	Pyll	Pronësi



2.FORMULAR PËR INTENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE (Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Për një shtesë në listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.662, datë 11.6.2009

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Bashkia Konispol										
Nr. rendor	Nr.i pasurisë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosores (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Nr. i ngastrës	Destinacioni	Sip.në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni entë me përgjegjësi administrative	Institucioni entë përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	77		Bregu i Soqipeve	47	Kullotë	99 (110)	“			Shtesë sip.në inventar
2	79		Përroi i Gjonit	53	“	99 (110)	“			Shtesë sip.në inventar
3	109	Ek.kull.Konispol	Nartë-Likojan	50	Kullotë	160	“	“	“	
4	110	Ek.kull.Konispol	Narta	51	“	120	“	“	“	
5	111	Ek.kull.Konispol	Faqja e Rrezes	54	“	90	“	“	“	
6	112	Ek.kull.Konispol	Faqja e Kuqe	55	“	105	“	“	“	
7	113	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Psimeno	1	Kullotë	160	Kullotë	MMPAU	DSHP	
8	114	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Shënkolli	2	“	205	“	“	“	
9	115	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Faqja mbi Vodenë	3	“	145	“	“	“	
10	116	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Mali Horaf	4	“	215	“	“	“	
11	117	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Faqet mbi Kallame	5	“	220	“	“	“	
12	118	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Kullotë e postës të Mursisë	6	“	140	“	“	“	
13	119	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Mandillo	7	“	90	“	“	“	
14	120	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Faqja e Cengelit	8	“	80	“	“	“	

15	121	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Lugina e Kataetos	9	Kullotë	80	Kullotë	MMPAU	DSHP	
16	122	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Faqja e Tunelit	10	“	75	“	“	“	
17	123	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Gropa e Çiflikut	11	“	165	“	“	“	
18	124	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Gropat e Paganes	12	“	215	“	“	“	
19	125	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Shkëmbi i Barmihos	13	“	120	“	“	“	
20	126	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Cuka e Ajtojtit	14	Kullotë	30	Kullotë	MMPAU	DSHP	
21	127	Ek.kullosor Stillo-Vrinë	Ajtoji	15	“	70	“	“	“	
22	128	Ek.pyjore Mile-Stillo	Orrla	29	Pyll	48.5	Pyll prodhues	MMPAU	DSHP	
23	129	Ek.pyjore Mile-Stillo	Orrla e Katajetos	30	“	51.5	“	“	“	
24	130	Ek.pyjore Mile-Stillo	Pylli i Cengelit	31	“	14.5	“	“	“	
25	131	Ek.pyjore Mile-Stillo	Pylli i Kukos	32	“	35	“	“	“	
26	132	Ek.pyjore Mile-Stillo	Pylli i Kalenxes	33	“	27	“	“	“	
27	133	Ek.pyjore Mile-Stillo	Pylli i Pleshëm	34	“	7.5	“	“	“	
28	134	Ek.pyjore Mile-Stillo	Pylli i piramidës kufitare 78-79	35	“	40	“	“	“	
29	135	Ek.pyjore Mile-Stillo	Kepi i Stillos (psimeno)	36	“	50	“	“	“	
30	136	Ek.pyjore Mile-Stillo	Lugina e gjirit të madh	37	“	44.5	“	“	“	
31	137	Ek.pyjore Mile-Stillo	Kodra e Lofates	38	“	45	“	“	“	
32	138	Ek.pyjore Mile-Stillo	Sheshet e malit Koraf	39	“	48.5	“	“	“	
33	139	Ek.pyjore Mile-Stillo	Anësoret e lumit Pavlo (argjinatura)	40	Bimësi pyjore	6	“	“	“	



VENDIM
Nr.19, datë 11.1.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË CEREMONIVE FUNEBRE SHTETËRORE DHE ZYRTARE, NË NDERIM TË TË NDJERIT LEKA ZOGU I E TË TË NDJERIT SABRI GODO, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET NR.808, DATË 30.11.2011 DHE NR.825, DATË 3.12.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, t’i shtohet fondi prej 1 281 161 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të ceremonisë funebre shtetërore, në nderim të të ndjerit Leka Zogu I dhe organizimin e ceremonisë funebre zyrtare, në nderim të të ndjerit Sabri Godo.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Pika 4 e vendimit nr.808, datë 30.11.2011 të Këshillit të Ministrave dhe pika 5 e vendimit nr.825, datë 3.12.2011 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.20, datë 11.1.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.839, DATË 5.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË PAGUAR DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTËSUESE PËR NDËRTIMIN E BURIMEVE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME FUQI TË INSTALUAR JO MË PAK SE 5 MW”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.839, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime.

1. Në pikën 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në paragrafin e parë, fjalët "... në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ..." zëvendësohen me "..., brenda datës 10 të muajit pasardhës, në drejtorinë rajonale ku është i regjistruar ...".

b) Në shkronjën "a", fjalët "... për një periudhë tremujore ..." zëvendësohen me "... për një periudhë njëmujore ...".

2. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Rimbursimi i akcizës për lëndën djegëse të konsumuar, të llogaritur sipas formulës, bëhet në mënyrë automatike nga drejtoria rajonale e tatimeve ku është i regjistruar subjekti, nga llogaria e veçantë buxhetore, e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim.

12.1. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar në rast se subjekti, që ka paraqitur kërkesën për rimbursim, plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë;

b) Është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;

c) Nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore apo penalitete të papaguara;

ç) Ka deklarim të rregullt të TVSH-së dhe s'ka penalizime.

12.2. Kërkesa e paraqitur nga subjekti, që plotëson kriteret e sipërpërmendura për rimbursimin automatik, vlerësohet dhe për të procedohet, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga inspektorët e drejtorisë rajonale tatimore. Kërkuesit për rimbursim mund të kontaktohen për të sqaruar problemet, por atyre nuk do t'u kërkohen dokumente shtesë, përveç dokumenteve të përcaktuara në këtë pikë. Kërkesat, që nuk plotësojnë kushtet, do të dërgohen për kontroll dhe, në këtë rast, kërkuesit mund t'i kërkohet të paraqesë dokumente shtesë.

12.3. Në rast se kërkesa për rimbursim paraqitet nga një person i tatueshëm për herë të parë, organi tatimor duhet të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave. Rimbursimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike pas miratimit të shumës për t'u rimbursuar.

12.4. Në rast se drejtoria rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nuk procedon me rimbursimin automatik, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

12.5. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave.

12.6. Në rast se gjatë kontrollit rezulton se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet të kthejë të gjithë shumën e rimbursuar, si dhe mbi të zbatohen penalitetet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.

3. Në pikën 13, fjalët "... jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë ..." zëvendësohen me "... jo më vonë se 5 ditë ...".

II. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.21, datë 11.1.2012

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR
PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 9 BASHKI
DHE 19 KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 9 (nëntë) bashki dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerën 30 023 464 lekë (tridhjetë milionë e njëzet e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, përballohet nga Fondi i Kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

Nr.	Emri i NJQV-ve	Vlera
1	Bashkia Fier	9 755 500
2	Bashkia Korçë	151 875
3	Bashkia Belsh	1 904 602
4	Bashkia Ballsh	1 436 750
5	Bashkia Ura Vajgurore	1 847 980
6	Bashkia Sukth	686 250
7	Bashkia Kuçovë	2 479 100
8	Bashkia Divjakë	2 043 113
9	Bashkia Mamurras	2 332 000
10	Komuna Buçimas	287 714
11	Komuna Kurjan	28 313
12	Komuna Mollaj	437 400
13	Komuna Shezë	198 000
14	Komuna Poshnje	763 047
15	Komuna Velabisht	903 684
16	Komuna Pirg	171 240
17	Komuna Farkë	765 125
18	Komuna Miras	429 625
19	Komuna Velipojë	628 800
20	Komuna Hajmel	57 410
21	Komuna Fiershegan	1 110 750
22	Komuna Liqenas	99 000

23	Komuna Shushicë (Elbasan)	625 710
24	Komuna Vertop	338 250
25	Komuna Mollas (Kolonjë)	48 120
26	Komuna Zharrëz	206 250
27	Komuna Grekan	244 356
28	Komuna Dardhas	43 500
Shuma		30 023 464

VENDIM

Nr.22, datë 11.1.2012

**PËR DHËNIE FONDI SHITESË KOMUNËS MARKAT, TË NËNPRFEKTURËS SARANDË,
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT EMERGJENT “NDËRTIM MURI MBAJTËS DHE
SISTEMIM I UJËRAVE TË SHIUT NË QENDËR SHALËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Markat, të nënprefekturës Sarandë, në buxhetin e vitit 2012, t’i jepet fondi shtesë prej 4 592 390 (katër milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekësh, për zbatimin e projektit emergjent “Ndërtim muri mbajtës dhe sistemim i ujërave të shiut në Qendër Shalës”, projekt i cili lidhet me marrjen e masave mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësi të ndryshme.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, komuna Markat dhe nënprefekti i Sarandës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.23, datë 11.1.2012

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER
PROFESIONAL”, ME KOHË TË PJESSHME, NË VITIN AKADEMIK 2011 - 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153,



datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2011-2012, të jetë 1370, e cila ndahet, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të dytë, më kohë të pjesshme | 1230; |
| b) Kuotat për transferim studimesh | 40; |
| c) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 60; |
| ç) Kuota për ish-të përndjekurit politikë | 40. |

2. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, e përcaktuar në shkronjën “a” e pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kuota për transferim studimesh, e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuota e pranimeve për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet aplikantëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

5. Kuota e pranimeve për shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Kuota e pranimeve për ish-të përndjekurit politikë, e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë. Pranimet do të bëhen vetëm në rastet e plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

7. Çdo shtetas shqiptar që zotëron një diplomë universitare, së paku “Bachelor”, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

9. Tarifat e shkollimit dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit, për aplikantët që do të regjistrohen në vitin e parë, në programe të para studimi të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2011-2012, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Kandidatët që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personat që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë,

invalidët, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijët e policëve dhe ushtarakëve të rënë për shkak të detyrës dhe të ish-të përndjekurve politikë paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

11. Studentët e paguajnë tarifën e shkollimit, të ndarë në këste, në përputhje me kreditet e lëndëve që do të frekuentojnë në çdo vit akademik. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit për një lëndë sa herë e frekuenton atë.

12. Studentët e shkëlqyer përjashtohen nga tarifa e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

13. Shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare, shtetërore, është parashikuar ndryshe.

14. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1

KUOTAT E PRANIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL”, ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012

Nr.	Emërtimi i programit të studimit	Kuota UT	Kuota UE	Kuota UK	Kuota totale
1	Administrim-biznes	70			70
2	Kontabilitet	35			35
3	Financë	50			50
4	Studime ekonomike europiane	35			35
5	Marketing	35			35
6	Administrim-publik	70			70
7	Menaxhim turizmi	35			35
8	Mësuesi për lëndët matematikë-fizikë, me profil minor informatikë		60		60
9	Mësuesi për lëndët matematikë-informatikë, me profil minor fizikë		60		60
10	Mësuesi për lëndët biologji-kimi, me profil minor edukim shëndetësor dhe mjedisor		80		80
11	Mësuesi për lëndët gjuhë shqipe dhe letërsi		80		80
12	Mësuesi për lëndët histori-gjeografi, me profil minor edukatë qytetare		80		80
13	Mësuesi për lëndët edukatë qytetare-gjeografi, me profil minor histori		50		50
14	Mësuesi për lëndët edukatë qytetare-histori, me profil minor gjeografi		50		50
15	Mësuesi për lëndën gjuhë angleze, me profil minor gjuhë shqipe		50		50
16	Mësuesi për lëndën gjuhë frënge, me profil minor gjuhë shqipe		50		50
17	Mësuesi për lëndën gjuhë italiane, me profil minor gjuhë shqipe		50		50
18	Mësuesi për lëndën gjuhë gjermane, me profil minor		50		50



	gjuhë shqipe				
19	Punë sociale me fëmijët dhe familjen		80		80
20	Psikologji në institucione		80		80
21	Mësimdhënie			80	80
	Totali	330	820	80	1230

TABELA NR.2
TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR “MASTER PROFESIONAL” ME KOHË TË PJESSHME DHE
EDUKIMIN NË DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012

Nr.	Emërtimi i institucionit publik të arsimit të lartë	Tarifë për kredit për program të parë	Tarifë totale për program të parë
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Administrim-biznes	728	65 520
2	Kontabilitet	728	65 520
3	Financë	728	65 520
4	Studime ekonomike europiane	728	65 520
5	Marketing	728	65 520
6	Administrim-publik	728	65 520
7	Menaxhim turizmi	728	65 520
Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan Fakulteti i Shkencave Humane			
1	Mësuesi për lëndët matematikë-fizikë, me profil minor informatikë	728	65 520
2	Mësuesi për lëndët matematikë-informatikë, me profil minor fizikë	728	65 520
3	Mësuesi për lëndët biologji-kimi, me profil minor edukim shëndetësor dhe mjedisor	728	65 520
4	Mësuesi për lëndët gjuhë shqipe dhe letërsi	728	65 520
5	Mësuesi për lëndët histori-gjeografi, me profil minor edukatë qytetare	728	65 520
6	Mësuesi për lëndët edukatë qytetare-gjeografi, me profil minor histori	728	65 520
7	Mësuesi për lëndët edukatë qytetare-histori, me profil minor gjeografi	728	65 520
8	Mësuesi për lëndën gjuhë angleze, me profil minor gjuhë shqipe	728	65 520
9	Mësuesi për lëndën gjuhë frënge, me profil minor gjuhë shqipe	728	65 520
10	Mësuesi për lëndën gjuhë italiane, me profil minor gjuhë shqipe	728	65 520
11	Mësuesi për lëndën gjuhë gjermane, me profil minor gjuhë shqipe	728	65 520
12	Punë sociale me fëmijët dhe familjen	728	65 520
13	Psikologji në institucione	728	65 520
Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë Fakulteti i Mësuesisë			
14	Mësimdhënie	728	65 520

VENDIM
Nr.51, datë 2.2.2012

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TOTALE 45 000 M² PJESË E PRONËS NR.117, ME EMËRTIM “KOMPANIA E ZBULIMIT, RAKETAVE KT, TË BRRSH”, ME VENDNDODHJE NË SHARRË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe totale 45 000 m² pjesë e pronës nr.117, me emërtim “Kompania e zbulimit, raketave KT, të BRRSH”, me vendndodhje në Sharrë, Tiranë, sipas planrilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi, për ta përdorur për sistemimin dhe për ngritjen e një vendqëndrimi të përhershëm të familjeve të komunitetit rom.

2. Sipërfaqja e truallit dhe e ndërtesave, pjesë të pronës nr.117, me emërtim “Kompania e zbulimit, raketave KT, të BRRSH”, Sharrë, Tiranë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PLAN - RILEVIMI

PREGATITI:

TALBA shpk, Tirane
K. QIRIAZI
Isha Nr:N 2664/3
e Prgatitjes: Prill 2011



Vula/Pirma

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3321
NR. I PASURISE. ----- VOL. FQ.
INDEKSI I HARTES. K - 34 - 100 - (26-A)
SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE
Q/F SHARRE Rr/L. -----
P/G Sh. K. Ap.
PRONARI: KOMANDA e Br.R.SH


— Siperfaqja e repartit ushtarak e kaluar me VKM Nr.515 dt. 18.07.2003,
dhe e regjistruar me Nr. hipotekor 553 dt 30.12.2004.

SIP.TRUALLIT = 85759,0m²
SIP.NDERTESE = 1657,05m²



Siperfaqja e pretenduar per tjetersim.

SIP.TRUALLIT = 45000 m²
SIP.NDERTIMIT = 1200,99m²



UDHËZIM
Nr.7, datë 10.1.2012

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE TË PROCESVERBALEVE, QË DO TË
PLOTËSOHEN NGA PËRFAQËSUES TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË
BASHKIVE/NJËSIVE BASHKIAKE/KOMUNAVE, PËR RASTET E FËMIJËVE TË
GJETUR DHE TË FËMIJËVE TË PAREGJISTRUAR NË GJENDJEN CIVILE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pikës 1, 2, 3 të nenit 40, pikës 2 dhe 7 të nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, të cilët duhet të përcaktohen më parë nga titullari përkatës, kur konstatojnë sipas rastit:

a) fëmijë, të cilët janë të pajisur me “certifikatën e asistencës në lindje”/“procesverbalin e hartuar në kohën e lindjes”, por që për shkaqe të ndryshme nuk janë të regjistruar dhe nënat e tyre i kanë lënë nën kujdesin e të afërmeve;

b) fëmijë të lindur dhe të pajisur me dokumentacion, por që nuk janë regjistruar në kohë për arsye subjektive;

c) fëmijë të gjetur, të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacion, “certifikatën e asistencës në lindje”/“procesverbalin e hartuar në kohën e lindjes”; duhet të hartojnë menjëherë procesverbalin dhe të ndjekin regjistrimin e fëmijës në zyrën e gjendjes civile, nën juridiksionin territorial të së cilës është gjetur/deklaruar si i paregjistruar fëmija.

2. Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit që kanë gjetur/konstatuar rastin, bëjnë dokumentimin e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1/a., b., c., duke plotësuar përkatësisht formularin tip Mod.1/Mod.2 Mod.3 në tri kopje.

3. Secili përfaqësues krijon dosjen përkatëse, në të cilën përfshihen:

- kopja e procesverbalit;
- asistenca e lindjes, apo çdo dokument që mund të disponojë i interesuari sipas rastit;
- foto të çastit të gjetjes së fëmijës.

4. Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, si dhe pala e interesuar nëse ka, së bashku me fëmijën, paraqiten para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile për të bërë deklarinimin e lindjes së fëmijës pas plotësimit të praktikave, sipas përcaktimeve në pikën 1:

a) për rastin e përcaktuar në pikën 1.a., do të plotësohet procesverbali Mod.1, të cilit i bashkëlidhet “certifikata e asistencës në lindje”/“procesverbali i hartuar në kohën e lindjes”, që disponojnë të afërmit e fëmijës;

b) për rastin e përcaktuar në pikën 1.b., do të plotësohet procesverbali Mod.2., të cilit i bashkëlidhet “certifikata e asistencës në lindje”;

c) për rastin e përcaktuar në pikën 1.c të këtij udhëzimi, do të plotësohet procesverbali Mod.3., të cilit i bashkëlidhet “raporti mjekësor”, i plotësuar nga mjeku i zonës ku është gjetur fëmija.

5. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile zbaton rast pas rasti të gjitha procedurat e parashikuara në ligjin nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, për këto kategori fëmijësh dhe për çdo akt të mbajtur njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.



6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryetarët e bashkive/njësive bashkiake/komunave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
7. Ngarkohet Zëvendësministri i Brendshëm për monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

Mod.1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

PROCESVERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.a)

I mbajtur sot, më datë ____ . ____ . ____ , nën juridiksionin e territorit të
(dita, muaji, viti)

bashkisë/njesisë bashkiake/komunës _____, rrethi _____ nga;

1.Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i Policisë së Shtetit, komisariati _____;

2.Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës _____;

N ë prani të:

Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(numri personal)

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është
_____ dhe se fëmija ka lindur në _____
(lidhja biologjike me fëmijën) (institutcion, shtëpi, etj.)

dhe ka mbetur i paregjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 39, të pikës 2 të nenit 40 dhe të pikës 2 dhe 7 të nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, mbahet ky procesverbal për konstatimin e gjetjes së fëmijës, faktin e lindjes së të cilit, deklaruesi e vërteton me dokumentin “asistencë lindje”, që i bashkëlidhet këtij procesverbal.

Shënim. Pas regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile, sipas nenit 39 (pika 1, 2, 3, 5) të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile” dhe pajisjes së tij me certifikatë lindjeje, personi i interesuar duhet t’i drejtohet gjykatës për marrjen e kujdestarisë së fëmijës/ose për njohjen e atësisë/amësisë.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)

Pala e interesuar

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)

Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

PROCESVERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.b)

I mbajtur sot, më datë ____ . ____ . ____ , nën juridiksionin e territorit të
(dita, muaji, viti)

bashkisë/njësisë bashkiake/komunës _____, rrethi _____ nga;
1. Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)
përfaqësues i Policisë së Shtetit, komisariati _____;
2. Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)
përfaqësues i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës _____;
në prani të,
Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)
Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(numri personal)

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është
_____ dhe se fëmija ka lindur në _____
(lidhja biologjike me fëmijën) (institucion, shtëpi, etj.)

dhe ka mbetur i paregjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Në mbështetje të pikës 2 dhe 7 të nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, mbahet ky procesverbal për konstatimin e gjetjes së fëmijës së paregjistruar, faktin e lindjes së të cilit deklaruesi e vërteton me dokumentin “asistencë lindje”, që i bashkëlidhet këtij procesverbal.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)

Përfaqësuesi i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)

Pala e interesuar

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

PROCESVERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.c)

I mbajtur sot, më datë _____, _____, _____, nën juridiksionin e territorit të
(dita, muaji, viti)

bashkisë/njesisë bashkiake/komunës _____, rrethi _____ nga;

1. Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i Policisë së Shtetit, komisariati _____;

2. Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës _____;

në prani të,

Z/znj. _____, i pajisur me dokument identifikimi _____;
(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është

_____ dhe se fëmija ka lindur në _____
(lidhja biologjike me fëmijën) (institutcion, shtëpi, etj.)

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 39, të pikës 2 të nenit 40 dhe të pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, mbahet ky procesverbal për konstatimin e fëmijës së gjetur, të seksit _____, në vendin e quajtur _____.

Shënim. Pas regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile, sipas nenit 39 (pika 1, 2, 3, 5) të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile” dhe pajisjes së tij me certifikatë lindjeje, personi i interesuar duhet t’i drejtohet gjykatës për marrjen e kujdestarisë së fëmijës/ose për njohjen e atësisë/amësisë.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit

Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)

Pala e interesuar

(emër, atësi, mbiemër)
(nënshkrimi)

URDHËR
Nr.6, datë 5.1.2012

PËR LEJIMIN E FILLIMIT TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT JOUNIVERSITARE PROFESIONALE, INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË PRIVAT “AKADEMIA E NDËRTIMIT E TIRANËS” NË PËRPUTHJE ME LICENCËN E DHËNË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.775, datë 2.11.2011 “Për licencimin e institucionit të arsimit të lartë privat “Akademia e Ndërtimit e Tiranës””, Tiranë,

URDHËROJ:

1. Lejimin, për fillimin e veprimtarisë akademike të institucionit të arsimit të lartë privat “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, për programet e studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

- a) Inxhinieri ndërtimi;
- b) Inxhinieri hidroteknike.

2. Lejimin, për ushtrimin e veprimtarisë akademike të institucionit të arsimit të lartë privat “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, për programet e studimit jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë profesionale jouniversitare, me profilet:

- a) Ndhmësinxhinier në ndërtim;
- b) Ndhmësinxhinier në arkitekturë.

3. Veprimtaria akademike, për programet e studimeve referuar pikës 1 dhe 2 të këtij urdhri, të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe institucioni i arsimit të lartë privat “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.10, datë 16.1.2012

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË QË PËRFUNDOJNË ME “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”, SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “HËNA E PLOTË” (BEDËR) TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 42/1 ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.165, datë 15.4.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Hëna e Plotë” (Bedër) e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare në “Master profesional” në:

- a) Mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm;



- b) Mësuesi, gjuhë turke për arsimin e mesëm.
2. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.165, datë 15.4.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Hëna e Plotë” (Bedër) e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i shkencave” në:
- a) Drejtësi, në profilet:
- i) E drejtë penale;
- ii) E drejtë ndërkombëtare.
- b) Shkenca komunikimi, në profilet:
- i) Marrëdhënie me publikun;
- ii) Gazetari.
3. Programet e studimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 vite akademike.
4. Programet e studimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.
5. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private “Hëna e Plotë” (Bedër).
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.11, datë 17.1.2012

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
“BACHELOR” NË “PSIKOLOGJI”, “TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE
KOMUNIKIMI” DHE “INXHINIERI TELEKOMUNIAKSIONI” DHE PROGRAMIN E
INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË
“ARKITEKTURË” DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO
PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “VITRINA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.608, datë 6.5.2009 “Për licencimin e shkollës së lartë private “Vitrina””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë shkollës së lartë private “Vitrina”, Tiranë, të programeve të reja të studimit të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

- a) Psikologji;
- b) Teknologji informacioni dhe komunikimi;
- c) Inxhinieri telekomunikacioni.

2. Hapjen pranë shkollës së lartë private “Vitrina”, Tiranë, të programit të ri të studimit të integruar të ciklit të dytë, që realizohet me 300 kredite, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike,

në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në:

a) Arkitekturë.

3. Këto programe studimi, në bazë të vendimeve nr.167, datë 15.4.2011, dhe nr.234, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Programet e studimit të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhri, fillojnë veprimtarinë akademike në vitin akademik 2011-2012.

5. Shkolla e lartë private “Vitrina” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, sekretari i përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private “Vitrina”, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.12, datë 17.1.2012

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
“MASTER I SHKENCAVE” NË “PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE E ZHVILLIMIT” DHE
“PSIKOLOGJI KËSHILLIMI KLINIK” DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE
PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE
“UNIVERSITETI “KRISTAL””, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.761, datë 6.12.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave Politike të shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, të programeve të reja të studimit të ciklit të dytë, që realizohen me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në:

a) Psikologji shkollore dhe e zhvillimit;

b) Psikologji këshillimi klinik.

2. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimit nr.276, datë 4.11.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Këto programe studimi fillojnë veprimtarinë akademike në vitin akademik 2011-2012.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.



5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.16, datë 17.1.2012

**PËR RIORGANIZIMIN E FAKULTETIT TË MËSUESISË NË FAKULTETIN E EDUKIMIT
DHE FILOLOGJISË DHE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE NATYRORE DHE
SHKENCAVE HUMANE NË UNIVERSITETIN “FAN.S.NOLI” KORÇË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikave 5 dhe 6 të nenit 41 dhe pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e Fakultetit të Mësuesisë të Universitetit “Fan.S.Noli” të Korçës në dy fakultete, përkatësisht:

- a) Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë;
- b) Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane.

2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i Gjuhë-Letërsisë;
- b) Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
- c) Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë dhe Histori-Gjeografisë.

3. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron programe studimi të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

- a) Cikël i ulët;
- b) Cikël i ulët parashkollor;
- c) Histori-gjeografi;
- d) Gjuhë-letërsi;
- e) Gjuhë angleze;
- f) Cikël i ulët dhe anglisht (filiali Pogradec);
- g) Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge.

4. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron programe studimi të ciklit të dytë, që realizohen me 90 kredite me kohëzgjatje normale 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Master profesional”, në:

- a) Gjuhë angleze;
- b) Gjuhë -letërsi, me profil minor në “Sporte”;
- c) Gjuhë-letërsi, me profil minor në “Arte”;
- d) Master profesional për shkollat profesionale.

5. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i Matematikës;
- b) Departamenti i Informatikës dhe Fizikës;
- c) Departamenti i Infermierisë;
- d) Departamenti i Shkencave Sociale.

6. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ofron programe studimi të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Bachelor”, në:

- a) Matematikë-fizikë;
- b) Matematikë-informatikë;
- c) Teknologji informacioni;
- d) Biologji-kimi;
- e) Filozofi-sociologji;
- f) Infermier i përgjithshëm;
- g) Infermier mami.

7. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave humane ofron programet e studimit të ciklit të dytë, që realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatje normale 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik, në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë “Master profesional” në:

- a) Filozofi-sociologji, me profil minor në “Edukim qytetar”;
- b) Matematikë-fizikë, me profil minor në “Informatikë”.

8. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ofron programin e studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatjen normale 2 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i shkencave”, në:

- a) Filozofi sociale.

9. Efektet financiare për zbatimin e këtij urdhri përballohen nga buxheti i universitetit “Fan.S.Noli” Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Fan.S.Noli” i Korçës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



VENDIM
Nr.1, datë 20.1.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese,	drejtues i seancës
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 27.10.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr.41/17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ilmi Çela, Daut Zyberi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, Zyra e Përmbarrimit Durrës

OBJEKTI: Shfuqizimi, si antikushtetues, i vendimeve nr.10-2008-166 (301), datë 3.6.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.00-2010-481, datë 23.4.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit kanë qenë punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, në repartin “Shqiponja”. Me urdhrat nr.448 dhe nr.450, të datës 3.6.2006 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës, kërkuesit janë përjashtuar nga radhët e Policisë së Shtetit. Shkaku i përjashtimit ka qenë i njëjtë për të dy kërkuesit: “Abuzime të rënda me atributet e punonjësit të policisë dhe mirëbesimit publik”.

2. Pas kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.648, datë 5.3.2007, ka vendosur, *inter alia*, anulimin e urdhrave nr. 448 dhe nr.450, datë 3.6.2006 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës, për përjashtimin nga radhët e policisë të kërkuesve, si dhe detyrimin e të paditurit, Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, të rikthejë në detyrën e mëparshme kërkuesit. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe është kthyer në titull ekzekutiv. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr.211, datë 26.4.2007, duke urdhëruar Zyrën e Përmbarrimit Durrës të ekzekutojë vendimin nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

3. Zyra e Përmbarrimit Durrës fillimisht i ka dërguar lajmërim për ekzekutim vullnetar Drejtorisë së Policisë të Qarkut Durrës, me objekt: “rikthim në punë dhe anulim të aktit administrativ” dhe më pas i ka dërguar shkresë për zbatimin e detyrueshëm të urdhrit ekzekutiv të mësipërm. Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, në përgjigje të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nga Zyra e Përmbarrimit, është treguar e gatshme t’i rimarrë në punë kërkuesit, por për arsye të ristrukturimit dhe riorganizimit të ri të policisë nuk ka qenë i mundur rikthimi i tyre në punë.

4. Kërkuesit kanë paraqitur një tjetër kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për pagesën e pagave për kohën kur kanë qenë të papunë, në zbatim të nenit 129/1 të Kodit të Punës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pranuar padinë dhe me vendimin nr.2994, datë 12.11.2007, ka vendosur detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, t’u paguajë kërkuesve pagën për të gjithë kohën e qëndrimit të tyre pa punë, e cila përfshin periudhën nga dita e shkëputjes nga puna deri në ditën e rikthimit në detyrë.

5. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.10-2008-166 (301), datë 8.6.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.2994, datë 12.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj e prova.

6. Pas ushtrimit të rekursit nga kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2010-481, datë 23.4.2010, ka vendosur, në Dhomë Këshillimi, mospranimin e rekursit me motivacionin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. **Kërkuesit** i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”), ku kërkojnë shfuqizimin e vendimeve nr.10-2008-166 (301), datë 8.6.2010 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.00-2010-481, datë 23.4.2010 të Gjykatës së Lartë dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Më konkretisht, kërkuesit parashetrojnë:

7.1 Vendimi nr.10-2008-166 (301), datë 3.6.2008, i Gjykatës së Apelit Durrës është dhënë në kundërshtim me ligjin sepse gjykata nuk e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në bazë të Kodit të Punës dhe ligjit të Policisë së Shtetit, pasi:

a) Gjykata nuk i ka dhënë zgjidhje çështjes nëse janë apo jo efektivë të Policisë së Shtetit kërkuesit pas anulimit të urdhrave të përjashtimit;

b) Arsyetimi i gjykatës se Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës është përpjekur t’i marrë kërkuesit në punë, por është penguar për shkak të reformës, është i pabazuar në ligj.

7.2 Vendimi nr. 00-2010-481, datë 23.4.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është dhënë në kundërshtim me ligjin, sepse Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar respektimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata e Apelit Durrës.

7.3 Vendimi gjyqësor i formës së prerë nr.648, datë 5.3.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nuk është ekzekutuar brenda një afati të arsyeshëm.

8. **Subjekti i interesuar**, Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, ka parashtruar me shkrim se çështja nuk përbën objekt gjykimi kushtetues dhe ka paraqitur dokumentet që zotëron në lidhje me kërkuesit.

9. **Subjekti i interesuar**, Zyra e Përmbarrimit Durrës, ka parashtruar me shkrim se e ka të pamundur ekzekutimin e vendimit dhe ka paraqitur përpara Gjykatës dokumentacionin përkatës në lidhje me veprimet përmbarrimore të kryera prej saj.

II

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, pasi pretendimet e tyre përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës. Gjithashtu, ata



legjitimohen *ratione temporis*, duke pasur parasysh se kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se, në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, kërkesit legjitimohen vetëm për pretendimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Parashtrimet e tjera, në mbështetje të pretendimeve të antikushtetutshmërisë së vendimit nr.10-2008-166 (301), datë 3.6.2008, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr.00-2010-481, datë 23.4.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit material nga ana e gjykatave të zakonshme. Gjykata e ka ripohuar qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është atribut vetëm i gjykatave të zakonshme dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues (*shih vendimet nr.14, datë 3.6.2009; nr.11, datë 23.4.2009; nr.4, datë 28.2.2006 dhe nr.35, datë 20.12.2005; nr.106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Veç kësaj, vërehet se pretendimet në lidhje me vendimet e mësipërme kërkesit i kanë paraqitur për të evidentuar se iu është cenuar e drejta e “rikthimit në punë”, si një e drejtë e fituar nga vendimi i formës së prerë nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata çmon se vendimet e Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Lartë, të cilët sipas kërkesve janë të cenueshëm, kanë të bëjnë me vendimin nr.2994, datë 12.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “pagimin e pagesave të prapambetura” dhe jo me vendimin nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilit është vendosur “rikthimi në punë” i kërkesve. Si rrjedhim, këto pretendime janë haptazi të pambështetura.

B. Për pretendimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm

11. Kërkesit pretendojnë se që prej marrjes formë të prerë të vendimit nr.648, datë 5.3.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nr.211, datë 26.4.2007, ka kaluar një kohë e gjatë, e cila është e pajustificuar për ekzekutimin e vendimit.

12. Gjykata është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr.2, datë 1.2.2011; nr.35, datë 27.10.2010; nr.6, datë 4.3.2010 dhe nr.43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në vendimmarrjen e saj Gjykata ka pranuar se: “...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”. Më tej, “...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre” (*shih vendimet nr.6, datë 6.3.2009; nr.1, datë 19.1.2009; nr.43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata, duke u mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuarit dhe sjelljen e autoriteteve publike (*shih vendimin nr.14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata rikonfirmon qëndrimin se, në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 15.4.2011; nr.14, datë 15.4.2010; nr.8, datë 23.3.2010; nr.9, datë 1.4.2009; nr.1, datë 19.1.2009*).

16. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht se për vlerësimin e kompleksitetin të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 15.4.2010; nr.8, datë 23.3.2010; nr.9, datë 1.4.2009; nr.1, datë 19.1.2009*).

17. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarve është me rëndësi në këtë kontekst.

18. Në çështjen në shqyrtim, është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse Zyra e Përmbarrimit Durrës ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura rezulton se hapat proceduralë të ndërmarrë nga Zyra e Përmbarrimit Durrës janë:

- lajmërimi për ekzekutim vullnetar nr.715/H, datë 15.5.2007;
- shkresat nr.715, datë 28.6.2007, nr.715, datë 23.10.2007 dhe nr.715, datë 22.9.2008, ku i është tërhequr vëmendja debitorit për mosekzekutimin e vendimit;
- shkresat për ekzekutim të titullit ekzekutiv, drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut, përkatësisht me nr.684, datë 15.5.2007; nr.684, datë 10.7.2007 dhe nr.684, datë 17.12.2007.

19. Nga shpjegimet e vëna në dispozicion nga Zyra e Përmbarrimit Durrës, rezulton se kërkuari Ilmi Cela, në shkresën me nr.32 datë 10.12.2010, drejtuar Zyrës së Përmbarrimit Durrës, ka hequr dorë nga ekzekutimi i vendimit nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Për pasojë, Zyra e Përmbarrimit Durrës me vendimin nr.2208 prot. datë 16.12.2010, ka pushuar urdhrin e ekzekutimit nr.211, datë 26.4.2007 të vendimit nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kërkuari Ilmi Cela i është drejtuar shërbimit të përmbarrimit privat, me qëllim ekzekutimin e vendimit nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me shkresat nr.99 prot., datë 4.7.2011 dhe nr.115/1 prot., datë 29.9.2011, përmbarruesi privat i është drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

20. Në lidhje me kërkuarin tjetër Daut Zyberi, Zyra e Përmbarrimit Durrës ka sqaruar se Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, pavarësisht shkresave për ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nuk e ka zbatuar vendimin. Në pamundësi për ta ekzekutuar këtë vendim, përmbarruesi gjyqësor e ka parë të arsyeshme të nxjerrë vendimin nr.684 prot., datë 1.9.2008, për pushimin e urdhrin të ekzekutimit nr.211, datë 26.4.2007 të vendimit nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

21. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se Zyra e Përmbarrimit Durrës, për kërkuarin Ilmi Cela, i ka kryer veprimet përmbarrimore në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, ndërsa për kërkuarin tjetër, Daut Zyberi, Zyra e Përmbarrimit Durrës, në mënyrë të njëanshme dhe në



kundërshtim me nenin 616 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) ka pushuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke nxjerrë si pretendim pamundësinë për ta ekzekutuar atë. Në lidhje me këto veprime, Gjykata vlerëson se arsyet e pushimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga Zyra e Përmbarrimit Durrës, nuk janë të përligjura.

22. Në përgjigjet drejtuar Zyrës së Përmbarrimit, evidentohet se Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, në rolin e debitorit, pranon zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe gatishmërinë për t'i rikthyer në punë kërkuesit, por justifikohet se nuk ka mundësi ta ekzekutojë vendimin gjyqësor për arsye të ristrukturimit dhe riorganizimit të Policisë së Shtetit, si dhe mungesës së fondeve.

23. Gjykata është shprehur edhe më parë se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (*shih vendimin nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). I takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr.2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në funksion të analizës së sjelljes së autoriteteve përkatëse shtetërore, Gjykata çmon se debitori, si palë në proces, si dhe organet përgjegjëse përmbarrimore të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duhet të kryejnë veprime konkrete në drejtim të zbatimit efektiv të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Organet shtetërore jo vetëm nuk mund të vënë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por janë të detyruar të marrin masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr.6, datë 6.3.2009; nr.6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa i përket sjelljes së kërkuesve, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, Gjykata çmon se nuk rezulton që sjelljet e kërkuesit të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

26. Urdhri ekzekutiv, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, mban datën 26.4.2007. Kanë kaluar katër vjet nga data që ka dalë ky urdhër dhe vendimi gjyqësor i formës së prerë ende nuk është zbatuar. Gjykata konstaton se debitori (Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës), ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar detyrimin ndaj kreditorëve (kërkuesit) dhe organi përgjegjës i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (Zyra e Përmbarrimit Durrës) nuk i ka marrë të gjitha masat përkatëse në drejtim të zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor, për sa i takon kërkuesit Daut Zyberi.

27. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se ndodhet përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshem.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e vendimeve nr.10-2008-166 (301), datë 3.6.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.00-2010-481, datë 23.4.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor nr.648, datë 5.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, brenda një afati të arsyeshem.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (drejtues i seancës), Petrit Pllloçi, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

VENDIM
Nr.2, datë 25.1.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 17.11.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 49/24 Akti, që i përket:

KËRKUES: Agron Bukaçi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve nr.15, datë 20.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.346, datë 15.12.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr.00-2009-315, datë 6.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka marrë titullin “oficer” me urdhrin nr.78, datë 26.7.1998 të Ministrit të Mbrojtjes. Me urdhrin nr.816, datë 23.5.2007 të Ministrit të Mbrojtjes, ai është emëruar në detyrën e komandantit të togës së tretë xheniere në Kompaninë e Mbështetjes Rajonale Shkodër. Kërkuesi nuk është paraqitur për të marrë detyrën deri në datën 12.6.2007, datë në të cilën është mbajtur procesverbali i mosparaqitjes në detyrë. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër (seksioni ushtarak) e ka akuzuar kërkuesin fillimisht për veprën penale të “dezertimit të kuadrit komandues” por më pas, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar paraprakisht ndryshimin e akuzës në “mosparaqitje e oficerëve dhe nënoficerëve aktivë”, të parashikuar nga neni 37/1 i Kodit Penal Ushtarak (KPU), për arsye se kërkuesi, në bazë të shkresës nr.86, datë 12.2.2008 të komandës pranë repartit ushtarak nr.1810, rezultonte i emëruar si oficer pranë këtij reparti.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka mundur ta gjejë kërkuesin, ndaj i ka caktuar atij një mbrojtës kryesisht. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.15, datë 20.3.2008, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për



kryerjen e veprës penale të “mosparaqitjes së oficerëve dhe nënoficerëve aktivë” të parashikuar nga neni 37/1 i KPU-së dhe e ka dënuar me 2 (dy) muaj burgim.

3. Kërkuesi ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër, pasi ka shqyrtuar pretendimet e kërkuesit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.15, datë 20.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe ndryshimin e masës së dënimit në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë.

4. Pas paraqitjes së rekursit nga ana e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se i mungonte nënshkrimi i mbrojtësit.

5. **Kërkuesi** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”), ku kërkon shfuqizimin e vendimeve nr.15, datë 20.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.346, datë 15.12.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr.00-2009-315, datë 6.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për arsye se cenojnë të drejtën e tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës.

6. Më konkretisht, kërkuesi pretendon se:

i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka zhvilluar procesin gjyqësor në mungesë dhe me avokat të caktuar kryesisht; vendimi i kësaj gjykate është i pabazuar në ligj;

ii) Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka analizuar siç duhet faktet;

iii) Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar rekursin e panënshkruar nga mbrojtësi, i ka mohuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

7. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka paraqitur me shkrim parashtrime në lidhje me çështjen, objekt i këtij shqyrtimi.

II

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; *ratione temporis*, duke pasur parasysh se kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, si dhe *ratione materiae*, pasi shqyrtimi i pretendimit se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, duke mos pranuar rekursin për arsye të mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit, është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për pretendimin për cenimin e të drejtës për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë (e drejta e aksesit)

9. Neni 31/ç i Kushtetutës parashikon se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme. Neni 43 i Kushtetutës parashikon: “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.”

10. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale (KPP), nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Shqyrtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr.21, datë 24.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedurat e gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në

këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (*shih vendimin nr.5, datë 4.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata vlerëson se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon *inter alia* se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Fjalja e parë e nenit duhet lexuar së bashku me fjalinë e dytë. Neni 435/2 i KPP-së ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Rekursi është akti procedural, në të cilin parashtrohen shkaqet, për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale, për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disiplinonjë paraqitjen e ankimit (nenet 407-421 të KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë.

13. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i tij. Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, sipas kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së. Gjykata çmon se, në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe nga fjalja vijuese e kësaj dispozite procedurale. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese nuk rezultojnë që Kolegji Penal të ketë vlerësuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore përkatëse dhe veprimet e saj për plotësimin e kërkesës formale për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi i kërkuesit.

14. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

C. Për pretendimet e tjera

15. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka zhvilluar procesin gjyqësor në mungesë dhe me avokat të caktuar kryesisht. Gjykata konstaton se, nga përmbajtja e dokumenteve të administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pas njoftimeve të njëpasnjëshme që i ka dërguar kërkuesit për t'iu paraqitur në gjykatë dhe pas



përpyekjeve për të gjetur vetë kërkuesin, i ka caktuar atij avokat kryesisht, në përputhje me nenin 141/1 të KPP-së.

16. Gjykata, në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka analizuar siç duhet faktet dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i pabazuar në ligj, vlerëson se këto pretendime janë haptazi të pabazuara, pasi kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit material dhe vlerësimin e fakteve nga ana e gjykatave të zakonshme. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka ripohuar qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe, në parim, mënyra e zbatimit të ligjit material është atribut i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr.23, datë 17.5.2011 dhe nr.106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesit i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, si një standard kushtetues i procesit të rregullt ligjor.

PËR KËTË ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2009-315, datë 6.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.2.2012
Doli nga shtypi më 3.2.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë